



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:191162

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06491946

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.845/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurit S. B., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1748/2022 të datës 06.10.2022, për shkak të veprës penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 20.11.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, të pandehurit S. B. me mbrojtësen e tij Av. Safete Tolaj, me datë 20.11.2024 e shpalli ndërsa me datë 22.11.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

S. B., i lindur me dt....., në fshatin P., Komuna e Deçanit, ku dhe banon në rr. “.....” nr. ..., i biri i M. dhe nënës Z., e gjinisë B., pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me nr. personal i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Më parë e gjerë me datë. 26.06.2022 në “Bjeshkët e B.” Komuna e Deçanit, pjesë e parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, si investitor ndërton objekt pa leje, konkretisht një stan me material prej druri me dimensione 8x6, për të cilin kërkohet leja e tillë në bazë të ligjit për ndërtim dhe atë neni 7 dhe 14, ani pse nuk kishte leje ndërtimi, në atë mënyrë që pas zbatimit të planit operativ për identifikimin e ndërtimeve pa leje në zonën e lartëcekur nga pylltari i DAPK, është konstatuar se i pandehuri i lartëcekur në vendin përkatës ka filluar ndërtimin e një stani me karakteristika të përshkruara si më lartë.

- me këtë ka kryer veprën penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit S. B. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. RRËNOHET objekti i ndërtuar pa leje, i përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, shpenzimet për rrënim i bart i dënuari.
- III. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 06.10.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1748/2022 kundër të pandehurit S. B. për shkak të veprës penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 20.11.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurorja e shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, i pandehuri S. B. me mbrojtës sipas autorizimit Av. Safete Tolaj, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurores së shtetit dhe të mbrojtëses të pandehurit, në kuptim të nenit 242 par.2 dhe par. 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurorja e shtetit deklaroi “ Pasi i pandehuri e pranoi fajësinë, e ky pranim fajësie gjënë mbështetjen në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese, ndërsa konform nenit 359 par.2 të KPRK-së, të obligohet i pandehuri në rrënimin e objektit dhe shpenzimet t’i bartë i njëjti”.

Mbrojtësja e të pandehurit S. B., Av.Safete Tolaj në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit deklaroi: “I mbrojturi im me vullnetin e tij e ka pranuar fajësinë dhe është i penduar, ka pas ulyse se nuk ka qenë në njohuri për ndalimin e ndërtimit të stanit meqenëse është rritur në atë bjeshkë dhe në atë vend, mirëpo tani e ka kuptuar që është një vepër penale, andaj Gjykatës i propozojmë që lidhur me shqiptimin e dënimit të merrë për bazë pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese si dhe gjendjen e tij të moshuar dhe shëndetësore”.

I pandehuri S. B. deklaroi “ Pajtohem në tërësi me deklarinim e mbrojtëses time ”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përcaktimi i dënimit me burgim prej një (1) viti për të pandehurin u bë duke filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, qe sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par 2 të KPRK-së është dënimi prej katër (4) vite burgim¹.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin **nuk kemi fare rrethana renduese**, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi qe ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit S. B. do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi qe ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim dhe gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz qe të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.2 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”, e në këtë rast gjykata gjeti se mund të zbatohet dispozita për zbutjen e dënimit nga neni 71 par.1 pika 2 dhe 3 të KPRK-së, përkitazi me kushtëzimin e dënimit me burgim, përkatësisht duke u bazuar në faktin se i pandehuri e pranoi fajësinë në fillim të seancës së shqyrtimit fillestar dhe se i pandehuri shprehu keqardhje të thellë me rastin pranimit të fajësisë.

¹ Udhëzues për Politiken Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës, fq 201.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit S. B. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Kur u vendos për rrënimin e objektit të ndërtuar pa leje e të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 359 par.5 të KPRK-së ku është paraparë se “Ndërtimi pa leje në këtë nen duhet të rrënohet dhe shpenzimet e rrënit barten te kryesi”, pra dispozita materiale ka paraparë që objekti i ndërtuar pa leje duhet që të rrënohet dhe kjo nuk është dispozitë alternative për gjykatën por është normë obligative.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.845/22, me datë 22.11.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë